



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)

Fakulteti:	Fakulteti Juridik	
Departamenti:		
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	E drejta familjare dhe trashëgimore	
Statusi i lëndës:	Obligative	(Obligative apo zgjedhore)
Semestri:		(Dimëror / Veror)
Fondi i orëve:	2+1	(Sipas programit të aprovuar)
ECTS:	6	(Sipas programit të aprovuar)
Orari/Salla		
Viti akademik:		
Mësimdhënës/e:	Dr.Sc.Mimoza Aliu	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
Email:	mimoza.aliu@umib.net	
Telefon:		

PERMB AJTJE	E Drejta Familjare, përfshinë tërësinë e studimeve që i referohen marrëdhënieve familjare dhe martesore si dhe marrëdhënieve që lindin nga to. E Drejta Trashëgimore, përfshinë tërësinë e studimeve që i referohen marrëdhënieve që lindin në rastet e trashëgimit, rregullon marrëdhëniet e subjekteve në rastet e vdekjes, marrëdhëniet mortis causa.
QËLLI MI	Kjo lëndë mësimore ka për qëllim t'i mësoj studentët me njohurit themelore mbi rregullimin juridik të marrëdhënieve familjare, marrëdhënieve martesore dhe marrëdhënieve tjera që lindin nga to si dhe marrëdhëniet trashëgimore.

ARRIT SHMË RIA	<i>Në fund të kursit pritet që student/ja të jetë në gjendje të:</i> 1. Studentë do të fitojnë njohuri për këtë lëmi të së drejtës duke u bazuar në të drejtën pozitive në Kosovë me vështrim krahasimor edhe me të drejtat tjera pozitive. 2. Pas përfundimit të këtij kursi studentet do të aftësohen në lidhje me institucionet juridike që janë objekti i studimit në të drejtën familjare, do të trajtohen duke u bazuar në të drejtën pozitive në Kosovë si dhe në të drejtën familjare krahasimore me sistemin Kontinental dhe Common Law 3. Do të formulojnë vetë testamenti. 4.Do të din ti numërojnë dhe ti argumentojnë llojet e testamenteve bazuar në legjislacioni në fuqi. 5.Studentat do jenë në gjendje të debatojnë rreth dallimeve mes drejtës familjare dhe trashëgimore	
PROGR AMI	Javët	Tema
	Java - I	Tema: - nocioni dhe emërtimi i të drejtës familjare, - objekti i të drejtës familjare - metodat e studimit të së drejtës familjare, - parimet themelore të së drejtës familjare - burimet e së drejtës familjare - marrëdhëniet e së drejtës familjare me disiplinat tjera shkencore
	Java - II	Tema: - nocioni i familjes - llojet e familjes - funksionet e familjes - struktura e lidhjeve familjare (gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë, gjinia e adoptimit)
	Java - III	Tema: - fejesa - e drejta martesore - parimet themelore të së drejtës martesore - kushtet materiale për lidhjen e martesës - pengesat martesore - ndalesat martesore
	Java - IV	Tema: - kushtet formale për lidhjen e martesës - të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve
	Java - V	Tema: - zgjidhja e martesës - pasojat juridike të zgjidhjes së martesës - bashkësia jashtëmartesore si dukuri - shoqërore - efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore
	Java - VI	Tema: - e drejta prindërore (kuptimi dhe objekti) - ushtrimi i të drejtës prindërore

		- pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi i të drejtës prindërore
	Java - VII	Testi I
	Java - VIII	Tema: - adoptimi - procedurat e themelimit të adoptimit, efektet juridike të adoptimit - ndryshimet e reja legislative lidhur me adoptimit - vendosja e fëmijës në familjen tjetër për përkujdesje
	Java - IX	Tema: - e drejta e kujdestarisë - personat nënë kujdestari - kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur - kujdestaria ndaj personave me pazotësi të veprimit (zotësi të hequr të veprimit) - rastet e veçanta të kujdestarisë - rastet e veçanta të - kujdestarisë kur nuk janë përcaktuar me dispozita ligjore - pushimi i kujdestarisë
	Java - X	Tema: - detyrimet e ushqimit (mbajtja financiar) - personat e detyruar për dhënien e ushqimit - kushtet për dhënien e ushqimi
	Java - XI	Tema: - nocioni dhe emërtimi i të drejtës trashëgimore - objekti i të drejtës trashëgimore
	Java - XII	Tema: - parimet themelore të së drejtës trashëgimore - koha dhe vend i çeljes (hapjes) së trashëgimit - aftësia për të trashëguar, padenjësia për trashëgim, zëvendësimi i trashëgimisë (përfaqësimi) - Fitimi i trashëgimit - Renoncimi (heqja dorë) nga trashëgimi
	Java - XIII	Tema: - Administrimi i trashëgimit, ndarja e trashëgimit - Trashëgimia ligjore, Radhët e thirrjes në trashëgim ligjor - Zëvendësimi (përfaqësimi) në trashëgiminë ligjore
	Java - XIV	Testi II
	<u>Java - XV</u>	Tema: - Trashëgimia testamentare - Format e testamentit - Zotësia për të bërë testament dhe zotësia për të trashëguar, - Revokimi i testamentit dhe Pavlefshmëria e testamentit - Zëvendësimi në trashëgiminë testamentare

LITERATURA	Literatura themelore: ● Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011 ● Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010 ● Abdulla Aliu & Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007; Literatura plotësuese: Aleks Laurasi, Marrëdhëniet familjare, Laurasi, Tiranë, 2001 Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, 4 Tiranë, 1999 Santhipi Begeja, E drejta familjare e Shqipërisë, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë Leslie J.Harris & Lee E, Teitelbaum, Family Law, Aspen Law & Business, New York, 2000 D.Kelly Weisberg & Susan Frelich Appleton, Modern Family Law- cases and materials, Law, Aspen Law & Business, New York, 1998. Dr. Juliana Latifi, E drejta e trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë 2010 Nazmi Bicoku, E drejta e trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onrufi, 1999 Akte normative Ligji i Familjes i Kosovës, Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, GZ e KSAK nr,10/84, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë nr. 90/62 Ligji për Trashëgimi i Kosovës, Komentari Ligji Nr. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Ligjëratat: mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me qështjet e ndryshme tematike, Seminaret: çdo studentë duhet të punoj një punë kërkimore-shkencore që do të prezantohet përmes seminarit. Seminari duhet të jetë në mes 8 dhe 10 faqe, formati A4, formati i shkronjave fonti- time new roman, madhësia 12, hapësira 1.5. Çdo seminar duhet të ketë temën e trajtimit e cila formohet në formë të hipotezës apo pyetjes së hapur e cila duhet ta gjejë përgjigjen e qartë në përmbajtjen e seminarit me theks të veçantë në konkluzion. Tema e seminarit caktohet në konsultim me profesorin. Seminari duhet të përbëj një punë të pavarur shkencore dhe e shoqëruar me referenca (fusnota) të qarta dhe çdo kopjim ose plagjiaturë, do të reflektohet me vlerësim negativ në vlerësimin përfundimtar. Shqyrtimi i rasteve, gjatë mësimdhënies do të jetë pjesë e të mësuarit, përmes të cilave studentët do të kenë mundësi studimin në mënyrë analitike, të problemeve nga fusha e së drejtës familjare dhe trashëgimore, duke përfshirë edhe studimin e vendimeve gjyqësore. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë, duke mos i përjashtuar edhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive. Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Ushtrime në terren	-	-	-
Punë praktike	-	-	-
Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	15	15
Kolokiume /seminare	2	15	15
Detyra të pavarura	1	10	15
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	10	10
Projektet, prezantimet , etj	10	1	10
			150

VLERËSIMI

Metodat e vlerësimit [sipas Statutit dhe Rregullores për studime të UMIB-it]	
Testet/Kollokviumet	Testi I dhe II 10%
Test praktik gjatë ushtrimeve	10%
Rasti i studimit	20% (10% rastet e studimit në klasë dhe 10% rastet e studimit detyrë shtëpie)
Pjesëmarrja e studentëve	
Punim seminarik	10%
Interpretimi dhe prezentimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera	/
Detyrat dhe kurset gjatë semestrit	20%
Praktikë profesionale	/
Tjetër [specifiko]	/
Provimi final	50%

**POLITI
KAT
AKADE
MIKE**

Caktohen kriteret për vijueshmëri të rregullt dhe rregullat e mirësjelljes gjatë organizimit të mësimit.

Udhëzime të mëtejme :

● **Puna me kompjuter**

Punimet me shkrim duhet doemos të jenë të shkruara me kompjuter. Në punime janë të obligueshme respektimi i kriterëve qoftë për aspektin vizual ashtu edhe përmbajtjesor të punimeve të kërkuara. Gjatë punimeve kërkohet që të respektohen rregullat drejtshkrimore dhe stili APA

● **Etika në mësim**

Punimet e ndryshme semestrale duhet të jenë punime të secilit student. Nuk do të ketë tolerancë për kopjime, “huazime” nga interneti apo çfarëdo materiali tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme do të kenë vlerësime negative në vlerësimin përfundimtar të studentit.

● **Afatet**

Në marrëveshje me studentët do të përcaktohen afatet e dorëzimit të punimeve. Nuk do të ketë tolerancë për vonesë në dorëzimin e punimeve. Mosardhja në orën kur është shpjeguar detyra nuk e arsyeton studentin për mosdorëzim të punimit. Afati do të jepet më herët. Po qe se do të udhëtoni jashtë vendit, atëherë duhet të dorëzoni punimi më herët. Studenti/ja ka të drejtë të kërkojë konsultim me profesorin sa herë e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e punimit të tij/saj.

● **Rregullat e mirësjelljes dhe politikat akademike :**

- o pjesëmarrje aktive e studentëve në ligjëratat
- o pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje e lirë e opinionit, mendimit dhe qëndrimit akademik (me argumente)
- o e obligueshme puna e pavarur dhe shfrytëzimi i burimeve shtesë të informacionit (ëeb-faqet e ndryshme shkencore, revista shkencore, përmbledhje punimesh të konferencave etj.)
- o respektimi i orareve të ligjëratave pa cenuar lirinë akademike (telefonat celularë pa zë)
- o respektimi i fjalës, mendimeve dhe ideve të kolegëve
- o tolerancë e ulët ndaj ardhjeve me vonesë dhe daljeve pa ndonjë arsye të qëndrueshme
- o përgatitja dhe pajisja me ligjëratat përkatëse, (obligim i mësimeve të mësimdhënësit).

Mitrovicë

Bartës/e i/e lëndës:

____/____/____

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)